



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANE

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE REKRUTIMIT DHE
PROCEDURAVE**

PUNONJËS ME KONTRATË (ROJE)

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Urdhërit nr.3017 datë 29.01.2016 “për zbatimin e piker III/2 të Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.12620, datë 14.09.2015 për miratimin e strukturës dhe organikes te Aparatit të Bashkisë së Tiranës” Bashkia e Tiranës shpall procedurat e konkurimit për vendet e lira :

Roje në Njësinë Administrative Njësia Bashkiake Nr.8

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- 1) Të jetë shtetas shqiptar;
- 2) Të kenë të kryer arsimin e mesëm;
- 3) Të ketë leje drejtimi automjetesh
- 4) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar;
- 5) Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- 1) Kërkesë për aplikim (me shkrim dore);
- 2) Curriculum Vitae
- 3) Fotokopje e Kartës së Identitetit;
- 4) Fotokopje e Lejes se drejtimit te automjetit
- 5) Çertifikatë e përbërjes familjare;
- 6) Fotokopje e diplomës së shkollës dhe lista e notave e noterizuar;
- 7) Çertifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);
- 8) Fotokopje e librezës së punës.
- 9) Motivacioni i largimit nga puna e fundit (në se është i punësuar ose ka qenë i punësuar);

- 10) Raport mjeko-ligjor;
- 11) Vërtetim i gjendjes Gjyqësore;
- 12) Dy fotografi (2.5 x 3.5 cm).

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo në sportelet e Sektorit të Informimit dhe Shërbimeve për Qytetarët në Bashkinë e Tiranës brenda datës **2.03.2018**.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar

Kandidatët në intervistën me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me punën;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Tiranës do të shpallë fituesit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë në stendat e informimit të publikut. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Tiranë. Afati i ankimit është **2 ditë** nga data e shpalljes së rezultateve të testimit.